



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-030
Prishtinë, më 15 gusht 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 15 GUSHT 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq, ndërsa munguan Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Skënder Reçica dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d i t e:

1. Njoftimi i shtyllës IV të UNMIK-ut për lirimin e pjesshëm të Aneksit në ndërtesën e Kuvendit,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë për akomodimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë në ndërtesën e Kuvendit,
3. Shqyrtimi i Ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në sesionin vjetor.

1. Njoftimi i shtyllës IV të UNMIK-ut për lirim të pjesshëm të Aneksit në ndërtesën e Kuvendit

Kryesia, pasi u njoftua për lirim të katit III të aneksit në ndërtesën e Kuvendit nga shtylla IV e UNMIK-ut, mori këtë

V E N D I M

1. Personeli i Shtyllës IV të UNMIK-ut, të cilët e shfrytëzojnë pjesën tjetër të aneksit në ndërtesën e Kuvendit, duhet që të njëjtën ta lirojnë përfundimisht deri më datën 31 dhjetor 2008.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë për akomodimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë në ndërtesën e Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Qeverisë për akomodimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë në ndërtesën e Kuvendit dhe nevojën për lirim të ndërtesës së Kuvendit nga të gjitha institucionet e tjera të akomoduara, mori këto

V E N D I M E

I.

1. Miratohet kërkesa e Qeverisë për akomodimin e përkohshëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë në ndërtesën e Kuvendit.
2. Ministrisë së Forcës së Sigurisë i lejohej shfrytëzimi i pesë (5) zyrave në katin III të aneksit të ndërtesës së Kuvendit.
3. Afati i shfrytëzimit të hapësirave të përmendura në pikën 2 përfundon më 31 dhjetor 2008.

II.

Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit, deri më 31 dhjetor 2008 duhet ta lirojë ndërtesën e Kuvendit.

III.

Ministria e Drejtësisë, deri më 31 dhjetor 2008 duhet ta lirojë ndërtesën e Kuvendit.

IV.

Kabineti dhe personeli i Presidentit të Republikës së Kosovës, deri më 31 dhjetor 2008 duhet ta lirojnë ndërtesën e Kuvendit.

V.

1. Në katin I-rë të aneksit të ndërtesës së Kuvendit të akomodohej Kryesia e Kuvendit.
2. Në katin përdhës të aneksit të ndërtesës së Kuvendit të akomodohej kryetarët e grupeve parlamentare.
3. Në katin e dytë të aneksit të akomodohej kryetarët e komisioneve parlamentare.
4. Ngarkohet sekretari i Kuvendit, që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre vendimeve.

Kryesia, pas marrjes së vendimeve për lirim e ndërtesës së Kuvendit nga të gjitha institucionet e tjera të akomoduar, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Të nënshkruhet Memorandumi i mirëkuptimit në mes përfaqësuesit të Kuvendit dhe përfaqësuesve të të gjitha institucioneve të tjera të akomoduar në ndërtesën e Kuvendit (Presidenti i Republikës së Kosovës, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Shtylla IV e UNMIK-ut) për lirim e ndërtesës së Kuvendit.
2. Memorandumi i mirëkuptimit duhet të jetë në pajtim me vendimet e Kryesisë së Kuvendit për lirim e ndërtesës së Kuvendit nga institucionet e akomoduar, datë 15 gusht 2008.
3. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij përfundimi.

3. Shqyrtimi i Ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-së për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në sesionin vjetor

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën Asamblesë Parlamentare të NATO-s për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në sesionin vjetor, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Delegacionit të Kuvendit për pjesëmarrje në sesionin vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, prej 14 deri më 18 nëntor 2008.
2. Delegacioni i Kuvendit përbëhet prej tre(3) anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit: Xhavit Haliti, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq.

4. Të ndryshme

Kryesia, lidhur me shkrimin në gazetën ditore "Express", datë 14 gusht 2008, nxori këtë

Përfundim

Ngarkohet Zyra për Marrëdhënie me Media e Kuvendit, që të sqarojë artikullin, "Ministër, shko të shpija", të botuar në gazetën "Express" të Prishtinës, datë 14 gusht 2008, se nuk është fjala për anëtarin e Kryesisë së Kuvendit, Slllobodan Petroviq, por për një person tjetër. Sqarimi t'u dërgohet të gjitha medieve dhe të publikohet në Ueb faqen e Kuvendit.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale